2° - Shoqëria kryen veprimtarinë e logistikës së ndërmarrjes dhe menaxhim te strukturave te lidhjes së tranzitit; menaxhimi i terminaleve dhe platformave te konteniereve; hekurrudhore; portuale dhe aeroportuale për vete dhe të tretë; për llogari të të tretëve; me mjete vetjake dhe të të tretëve; realizimi; ushtrimi dhe koordinimi i shërbimeve të lidhura direkt me logistikën të aplikuar në transport dhe të lëvizjes së mallrave; menaxhim vetjak dhe për llogari të të tretëve të zonave të pajisura për magazinimin e mallrave dhe imballazhimin e tyre për dërgim; ndërtimin; mirëmbajtjen e zakonshme dhe të jashtëzakonshme; restaurimin dhe riparimin ruajtës; rinstrukturimin ndërtimor, si edhe cdo gjë tjeter të parashikuar në nenin 3 të Statutit të Shoqërisë që I bashkangjitet aktit në fjalë me gërmën "A" për të formuar me të pjesë plotësuese dhe përmajtëse.

3° - Kapitali i shoqërisë është i barabartë me 10.000,00 Euro (dhjetëmijë presje zero zero), i ndarë në kuota sipas nenit 2468 tëk.c. dhë është I nënshkruar nga ortakët si më poshtë:

- **Giovanni Vito Nitti PUTIGNANO** për 6.000 (gjashtë mijë presje zero zero) i barabartë me 60% (gjashtëdhjetë për qind) të kapitalit të shoqërisë.
- **Alessio GATTI** për 4.000 (katër mijë presje zero zero) I barabartë me 40% (dyzet për qind) të kapitalit të shoqërisë.

4° - shoqëria do të administrohet deri në revokim nga një Administrator i Vetëm me të drejta të zakonshme dhe të jashtëzakonshme administrimi nga zoti **Giovanni Vito Nitti PUTIGNANO** I cili e pranon detyrën dhe deklaron që nuk i përket asnjë rast të pamundësisë së zgjedhjes të parashikuar nga ligji.

5° - Administratori i emëruar që ortakët kanë derdhur 25% (njëzet e pesë përqind) të kapitalit të shoqërisë, në proporcione me kuotat përkatëse të nënshkruara, me një vlerë totale prej


2.500,00 (dymijë e pesëqind presje zero zero), duke lëshuar faturën përkatëse; kjo shumë është derdhur në datën e sotme me valutë të ligjshme, prej 1.500,00 (një mijë e pesëqind presje zero zero) nga ortaku **Giovanni Vito Nitti PUTIGNANO** dhe prej 1.000,00 (njëmijë presje zero zero) nga ortaku **Alessio GATTI**.

6° - Kohëzgjatja e shoqërisë është përcaktuar deri më 31 dhjetor 2050. Bilanci i shoqërisë mbyllt më tridhjetë e një dhjetor të cdo viti dhe bilanci i parë do të mbyllt më tridhjetë e një dhjetor dymijë e nëntëmbëdhjetë.

7° Shpenzimet e aktit në fjalëtë përcaktuara në njëmijë e pesëqind Euro janë në ngarkim të shoqërisë që i merr përsipër.

Pasi mu kërkua unë Noteri kam redaktuar aktin në fjalë – i shkruar nga një person i besuar me makinë dhe nga unë noteri me stilolaps nëdy faqe të një flete të cilin ua lexova palëve, bashkë me statutin bashkangjitur të cilat eaprovojnë.

Ky akt është nënshkruar në orën shtatëmbëdhjetë e njëyet.

Firmosur nga: Giovanni Vito Nitti Putignano, Alessio Gatti, Noter Ernesto Fornaro (me vulë)

SONILA PIRI
TRADUTTORE GIURATO
SPELLENESE ZYRTARE
Sonila Piri S

STATUTI

EMERTIMI - DEGA E SHOQERISE SE HUAJ – KOHEZGJATJA - OBJEKTI I SHOQËRISË

Neni 1 - Eshte krijuar një Shoqeri me perjegjesi te kufizuar e emërtuar “**TRILOGICA** ” S.r.l

Neni 2 – Selia e Shoqërisë është në SANTERAMO IN COLLE (BARI). Dega e shoqërisë se huaj mund të transferohet në cdo adresë të të njëjtës bashki me vendim të thjeshtë të Organit të Administrimit.

Organit Administrativ mund të themelojë e të mbyllë dege te shoqerive te huaja, degë dhe stabilimente territoriale, si në Itali ashtu edhe jashtë shtetit, me kusht që të mos përcaktohen si seli dytësore, duke i ngarkuar themelimin e tyre me ligj si kompetencë të asamblesë.

Vendbanimi i ortakëve në lidhje me marrëdhuet me shoqërinë, nënkuptohet ai zyrtar i vetëshoqërisë sipas mënyrave të parashikuara nga ligji sipas periudhës në fuqi.

Neni 3 – Shoqëria kyen veprimitari si:

- Logistikë të ndermarrjes dhe menaxhim te strukturave te lidhjes te tranzitit; menaxhimi i terminaleve dhe platformave te konteniereve; hekurrudhore; portuale dhe aeroportuale për vete dhe të tretë; për llogari të të tretëve; me mjete vetjake dhe të të tretëve;

- Realizim; ushtrim dhe koordinim i shërbimeve të lidhura direkt me logistikën të aplikuar në transport dhe të lëvizjes së mallrave; punë hamalli; menaxhim magazinash dhe ruajtje mallrash; menaxhim shërbimesh në operacione imbarkimi; zbarkimi, trasbord, depozitë dhe lëvizje në përgjithësi të kryer me ndihmën e mjeteve mekanike ose të ndryshme; ngarkim dhe shkarkim mallrash në përgjithësi:

- Menaxhim vetjak dhe për llogari të të tretëve të zonave të pajisura për magazinimin e mallrave dhe imballayhimin e tyre për dërgim; dërgim dhe transport të pakove të llojeve të ndryshme; si edhe të mallrave; kryerjen e veprimeve doganore në lidhje me to; magazinimin; ruajtjen dhe dorëzimin direkt dhe nëprerjet të tretëve të mallrave;

- Ndërtimin; mirëmbajtjen e zakonshme dhe të jashtëzakonshme; restaurimin dhe riparimin ruajtës; rinstrukturimin ndërtimor të ndërtesave civile; industriale dhe të monumenteve; përfshirë punimet e instalimit dhe mirëmbajtjes të impianteve elektronike; elektrike; civile; hidraulike; hidrotermike; ashensorë dhe ngarkues peshash, punime prodhimi dhe vendosje kasash, shërbime lëvizjesh të tokës dhe gërmime:


- Punime dhe lidhje pjesësh në kuadër të sektorit të prodhimit.

Shoqëria mund të krzejë të gjitha veprimet të patundshme; të tundshme dhe tregtare të nevojshme për arritjen e qëllimit të shoqërisë; përfshirë këtu edhe ato bankare; mund të marrë gjithashtu përsipër; drejtpërsëdrejti ose indirekt pjesëmarrje në biznes; kuota, pjesëmarrje në shoqëri të tjera ose sipërmarrje, të themeluara ose në proces themelimi; blerje degësh ndërmarrjesh që kanë objekt të njëjtë; të përafërt ose të lidhur me këtë, mund të marrë kredi dhe financime dhe të japë garanci të patundshme e të tundshme, reale ose personale; përfshirë edhe garanci bankare; me garanci obligacionesh te vetat pra të shoqërisë në të cilën ka direkt ose indirekt bit'znese ose püjesëmarrje që janë nën kontroll të përbashkët, por jo në qasje me publikun.

Neni 4 – Kohëzgjatja e Shoqërisë është e përcaktuar deri më tridhjetë e një dhjetor të vitit dymijë e pesëdhjetë dhe mund të shyhet ose të shkrihet paraprakisht me vendim të asamblesë.

KAPITALI I SHOQËRISË – KUOTA – SHPËRBËRJA – PËRJASHTIMI

Neni 5 - Kapitali i shoqërisë është i barabartë me 10.000,00 Euro (dhjetëmijë presje zero zero), I ndarë në kuota sipas nenit 2468 të k.c. kapitali i shoqërisë mund të lëvrohet me



me natyre kredie dhe të mira; gjithashtu mund të lëvrohen të gjitha elementët e aktivit të ndryshueshmët të vlersimit ekonomik.

Kuotat e kapitalit që u janë caktuar ortakëve për dhënien e shërbimit ose të shërbimeve në favor të shoqërisë duhet të garantohen nga një policë sigurimi ose nga një garanci bankare ose nga një derdhje me titull kaucion i tjetri përkatëse në monedhë.

Neni 6 – Kapitali i shoqërisë mund të shtohet edhe me lëshimin e kuotave që kanë të drejta të ndryshme nga ato në qarkullim me vendim të asamblesë së ortakëve, e cila mund t'i delegojë organit të Administrimit fuqitë e nevojshme për të realizuar shtimin, duke përcaktuar limitet dhe mënyrat e ushtrimit, si edhe ofertën e kuotave të reja të tretëve. Në këtë rast ortakëve që nuk kanë pranuar u takon vendimi i shtimit të kapitalit të shoqërisë, e drejta e tërheqjes sipas normës së nenit 2473. Në lidhje me shtimin e kapitalit ortakët do të kenë një të drejtë opsioni në proporcion me kuotat e tyre të pjesëmarrjes që duhet të ushtrojnë brenda tridhjetë ditëve nga vendimi i ortakëve, përvèc rastit të dhënisë natyrë. Në rast të refuzimit të së drejtës së opsonit, kjo e drejtë u jepet ortakëve që duan të ushtrojnë këtë të drejtë në proporcion me kuotat e tyre të pjesëmarrjes. Përjashtimi nga e drejta e opsonit nuk është i lejuar në hipotezën e shtimit të nevojshëm të kapitalit të shoqërisë për shkak të një zbritje për shkak humbje dhe për ripërtëritjen e humbjeve që e kalojnë kapitalin.

Në rast të reduktimit për humbje që influencojnë tek kapitali i shoqërisë me mbi një të tretën, mund të hiqet depozita pranë selisë së shoqërisë të dokumentacionit të parashikuar nga nisi 2482 bis par. 2 K.C., mbetet gjithashtu e drejta e ortakëve të marrin në asamble kopje të këtyre dokumentave.

Neni 7 – E drejta e tërheqjes mund të ushtrohet, përvèce në rastet e parashikuara nga ligji, edhe në rastet e mëposhtme:

- Zgjatja e afatit të kohëzgjatjes së shoqërisë;
- Përfshirjen e kushteve që ndalojnë transferimin e pjesëmarrjeve;
- Mos pëlqimi në momentin e përfshirjes së një ortaku të ri.

E drejta e tërheqjes ushtrohet nga ortakët në mungesë, që nuk janë dakort dhe/ose të abstenuar, nëpërmjet postës elektronike të certifikuar ose letër rekomande me kthim përgjigje, e cila duhet t'i mbërrijë shoqërisë brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga data e regjistrimit në Regjistrin e Bizneseve të vendimit që e legjitim, me përcaktimin e gjeneralitetëve të ortakut që është tërhequr dhe të kuotës përkatëse të pjesëmarrjes.

Vlera e rimburimit të kuotave nga ana e shoqërisë nuk mund të jetë më e vogël se vlera ideale e momentit të tregut të vlerave në qarkullim e përcaktuar duke mbajtu parasysh, me një vlerësi të drejtë, të siatasës së pasurisë së shoqërisë, të surplusit të fshehur, të vlerave jomateriale, të mundësisë së të ardhurave, të pozitës në merkato, si edhe të cdo rrethane dhe kusht që normalisht merret në konsideratë me qëllim përcaktimin e vlerës të pjesëmarrjeve dhe kjo gjë të jetë e konfirmuar në një relacion të posacëm nga një ekspert i emëruar me një marrëveshje të përbashkët midis palëve, ose në mungesë marrëveshje, nga Presidenti i Gjykatës të vendit në të cilin ka selinë shoqëria.

Rimbursimi duhet të kryhet gradualisht ose përmes blerjes proporcionale të kuotave nga ana e ortakëve të tjera, ose nga një e treta me pëlqimin paraprak të shprehur nga asambleja e ortakëve, ose duke përdorur rezerva të disponueshme me rrjedhojë rritjen e kuotave të ortakëve të tjera pra me reduktim të kapitalit të shoqërisë. Nëse mjetet e shoqërisë nuk e



bëjnë të mundur rimburshimin e pjesëmarrjes përmes reduktimit të kapitalit të shoqërisë, shoqëria vendoset në likujdim.

Neni 8 – Përjashtimi i një ortaku duhet të rezultojë nga vendimi i ortakëve me vendim të asamblesë, e marrë me kuorumin si më poshtë, duke mos u llogaritur në këtë shumicë kuota e ortakut që do të përjashtohet.

Përjashtimi mund të kryhet për pjesmarrjen në falimentime, hejqja e te drejtes nga autoritetet, pamundësia e ortakut ose për një dënim që sjell mosperfshirje edhe të përkohshme nga detyrat publike.

Ortaku që përfshihet në një nga këto raste ku parashikohet përjashtimi mund të pezullohet menjëherë nga pjesëmarrja në veprimtaritë e shoqërisë, me vendim të Organit Administrativ i cili duhet të mbledhë për këtë rast asamblenë e ortakëve me qëllim që të vendosë për këtë rast.

Përjashtimi i ortakut ka efekt pasi kanë kaluar 30 (tridhjetë) ditë nga data e komunikimit të vendimit të asambalesë. Ky njoftim duhet të kryhet nga Organi Administrativ përnes postës elektronike të certifikuar ose me letër rekomande me kthim të marrjes së njoftimit në dhjetë ditët e lira të mëpasshme nga vendimi.

Vendimi mund të kundërshtohet para oorganit të arbitrit të përcaktuar në nenin 27 të mëposhtëm.

Kundërshtimi ka efekt pezullimi të vendimit; pasi kanë kaluar tridhjetë ditë në të cilat vendimi nuk është kundërshtuar, ajo kthehet menjëherë në vepruese dhe mund të regjistrohet në Regjistrin e Sipërmarrjeve. Kuota e ortakut të përjashtuar do të likujdohet me mënyrat sipas nenit pararendës, duke përjashtuar reduktimin e kapitalit të shoqërisë.

Neni 9 – Ortakët mund të kryejnë financime fiskale dhe kredituese duke respektuar ligjet ne fuqi. keto financime do të konsiderohen pa interesa në favor të tyre, përvec rastit të një përcaktimi ndryshe nga Asambleja e ortakëve.

Neni 10 – Pjesëmarrjet janë nominative dhe u japid zotëruvese të tyretë drejta në shoqëri në masë proporcionale me pjesëmarrjen që secili zotëron.


Neni 11 – Pjesëmarrjet dhe e drejta e opzionit janë lirisht të transferueshme me akt midis të gjallësh, vetëm në favor të ortakëve të tjerë, të bashkëshortit të një ortaku pra të familjes në linjë të drejtë, ose shoqërive kontrolluese, të kontrolluara, të lidhura ose që i përkasin të njëjtë grup të shoqërisë.

Kalimi ndaj një shoqërie besuese ose rikalimi nga ana e kësaj (me paraqitjen paraprake të mandatit të besimit) tek zotëruesit e vërtetë nuk është subjekt për sa është përrcaktuar në nenin në fjalë.

Në të gjitha rastet e tjera të transferimit të pjesëmarrjes, u përket ortakëve të tjerë e drejta e preferencës me kushtet e mëposhtme.

Ortaku transferues duhet t'u dërgojë me postë elektronike të certifikuar ose me letër rekomande me kthim përgjigje, ortakëve të tjera propozimin e transferimit, i cili përmban gjeneralitetet e blerësit dhe përshkrimin e pjesëmarrjes që do të transferohet.

Në rast se pjesa takuese që do të kalohet është me natyrë të pazëvendësueshme, pra në rast të kalimit pa pjesë takuese, ortaku që ka ndërmend të kalojë duhet të përcaktojë në njoftim sipas pikës pararendëse, vlerën që i takon kuotës objekt transferimi; në mungesë të një përcaktimi të tillë njoftimi do të konsiderohet i pavlefshëm. Ortakët e tjerë mund të uishtrojnë preferencën duke derdhur shumën përkatëse të parave, përvec rastit kur kundërshtojnë vlerën



e caktuar; në këtë rast vlera e kuotës do të përcaktohet nga një arbitër i caktuar sipas nevojës në bayë të nenit 27 të mëposhtëm.

Ortakët marrës të njoftimeve sa më sipër duhet të ushtrojnë të drejtën e preferencës në lidhje me blerjen e kuotave të cilave u referohet njoftimi duke i dërguar ortakut ofrues deklaratën e ushtrimit të preferencës me letër rekomande të dorëzuar në postë jo më vonë se tridhjetë ditë nga data e dërgimit (që rezulton tek vula postare) të ofertës së preferencës.

Në rast të ushtrimit të të drejtës së preferencës nga më shumë ortakë, kuotat e ofruara i takojnë ortakëve të interesuar në proporcion me pjesëmarrjen e e secilit në zotërim.

Nëse njëri nga ata që kanë të drejtën e preferencës nuk mund e nuk dëshiron ta ushtrojë, e drejta e tij takuese i kalon automatikisht e në mënyrë proporcionale në favor të atyre ortakëve që anasjelltas kanë dëshirë ta ushtrojnë dhe që nuk kanë shprehur e refuzuar paraprakisht në momentin e ushtrimit të preferencës takuese.

Në cdo rast të mungesës së ushtrimit të së drejtës të preferencës, kuotat janë të transferueshme me pëlqimin paraprak të ortakëve të tjerë të cilët duhet te shprehen, përmes një vendimi të posacëm, pa detyrim arsyetimi me mazhorancat e parashikuara nga neni 14 pasardhës; në llogaritjen e mazhorancës nuk do të llogaritet pjesëmarrja e ortakut që kërkon pëlqimin.

Vendimi i ortkëve duhet t'i komunikohet ortakut transferues nga organi administrativ me letër rekomande brenda dzzet e pesë ditëve nga njoftimi i propozimit të transferimit sa më sipër e pra brenda dhe jo më vonë se 15 ditë nga afati i ushtrimit të preferencës. Në rast të mos pëlqimit, ortakut i takon e drejta e tërheqjes në bazë të nenit 7 pararendës; në rast të aprovimit, që do të njoftohet me letër rekomande në pesëmbëdhjetë ditët e mëpasshme, lëshuesi mund të kryejë lirisht transferimin në favor të tretëve.

Mungesa e përgjigjes së ortakëve të tjerë brenda afateve të prashtruara ndaj njoftimit të propozimit të transferimit duhet të nënkuftohet si heqje dorë nga e drejta e preferencës dhe aprovim pëlqimi.

Pjesëmarrjet janë të transferushme në mënzrë të lirë për kalim në rast vdekje.

ASAMBLEJA E ORTAKËVE


Neni 12 – Janë kompetencë eksklusive e asamblesë vendimet sipas nenit 2479 të K.C., si edhe në rastin kur kërkohet nga një ose më shumë administratorë d.m.th një numër ortakësh që përfaqësojnë të paktën 1/3 (një të tretë) e kapitalit të shoqërisë.

Asambleja e ortakëve mblidhet nga Organi administrativ edhe jashtë selisë së shoqërisë, vecse në Itali, me njoftim që u dërgohet personave që e gjëzojnë të drejtën, në adresën që rezulton në Regjistrin e Sipërmarrjeve, të paktën tetë ditë përpara datës së caktuar për t'u mbledhur, ose nëse është dërguar më tej, të merret njoftimi të paktën pesë ditë para mbledhjes, me letër rekomande, ose me cdo mjet tjeter të përshtatshëm që siguron provën e marrjes.

Në thirrje duhet të jenë të përcaktuara vendi, dita dhe ora e mbledhjes dhe lista e lëndëve që do të trajtohen.

Në rast pamundësie ose mosfunkcionim të organit të administrimit, asambleja mund të mblidhet nga organi i mundshëm i kontrollit ose nga disa ortakë që përfaqësojnë të paktën gjysmën e kapitalit të shoqërisë.

Në njoftimin e thirrjes mund të parashikohet një datë e mëtejshme për një mbledhje të dytë, vlejnë, megjithatë, të njëjtat mazhoranca të parashikuara për thirrjen e parë.



Asambleja e ortakëve për aprovimin e bilancit duhet të thirret të paktën një herë në vit, brenda njëqind e njëzet ditëve nga mbyllja e bilancit të shoqërisë ose brenda njëqind e tetëdhjetë ditëve nga mbyllja e bilancit të shoqërisë kur e kërkojnë nevoja të vecanta që rrjedhin nga struktura dhe nga objekti i shoqërisë.

Në mungesë të thirrjes asambleja e ortakëve është vlefshmërisht e përbërë kur është i përfaqësuar i gjithë kapitali i shoqërisë dhe të jenë prezent ose të informuar në lidhje me mbledhjen të gjithë administratorët dhe organi i kontrollit, nëse i emërur, dhe që asnje nuk është kundër në lidhje me trajtimin e cështjeve.

Neni 13 – Asambleja mund të zhvillohet edhe në më shumë vende, me lidhje audio dhe/ose video dhe sipas kushteve të mëposhtme për të cilat duhet mbajtur shënim në aktet përkatëse:

- Duhet të jenë prezent në të njëtin vend Presidenti dhe sekretari i mbledhjes, nëse eshte i emëruar, të cilët do të merren me përpilimin dhe nënshkrimin e procesverbalit;
- T'i mundësohet Presidentit të asamblesë të vërtetojë identitetin e dhe legjitimitetin e personave pjesëmarrës, rregullsinë e zhvillimit të mbledhjes, konstatimin dhe njiftimine rezultateve të votimit;
- T'i mundësohet personit që përpilon procesverbalin të përftojë saktësisht cështjet e asamblesë objekt të procesverbalizimit;
- T'u mundësohet pjesëmarrësve të marrin pjesë në diskutim dhe në votimin simultan të cështjeve në rend të ditës, si edhe të shikojnë, marrin ose të kalojnë dokumenta;
- Duhet të jenë të përcaktuara në njoftim (përvec rastit kur është një asamble totalitare, vendet audio dhe/ose video të lidhura nga ana e shoqërisë, në të cilët pjesëmarrësit mund të mblidhen, dhe mbledhja duhet të konsiderohet e kryer në vendin ku do të jetë prezent Presidenti dhe sekretari, nëse është i emëruar.

Në të gjitha vendet audio dhe/ose video të lidhura ku do të zhvillohet mbledhja duhet të jetë prezent fleta e të pranishëmve.

Neni 14 - Asambleja e ortakëve është e drejtuar nga Administratori i Vetëm ose nga Presidenti i Këshillit të administrimit ose nga më i vjetri i Administratorëve që kanë firmë të përbashkët dhe/ose të ndarë ose në rast të mungësës së tyre ose të pamundësisë, nga një person i caktuar nga pjesëmarrësit.

Presidenti ka të drejta të plota për të vërtetuar të drejtën e ortakëve për të marrë pjesë në asamble dhe përrregullsinë e përbërjes dhe mënyrat e votimit.

Ortakët mund të jenë të përfaqësuar me delegim të marrë përmes fax-it ose postës elektronike.

Ortakët që përfaqësojnë të paktën një të tretën e kapitalit të shoqërisë dhe që deklarohen në fillim të asamblesë që nuk janë të informuar mjaftueshmë në lidhje me cështjet për t'u vendosur, mund të kërkojnë që asambleja të shtyhet e jo më vonë se 5 (pesë) ditë.


Kjo e drejtë mund të ushtrohet vetëm një herë në lidhje me të njëjtën cështje.

Vendimet e asamblesë së ortakëve nëse merren me aprovimin e shumë ortakëve që përfaqësojnë 51% (pesëdhjetë e një përqind) të pjesmarrjeve në shoqëri.

VENDIMI I ORTAKËVE

Neni 15. – Në rastet e tjera vendimet e ortakëve mund të merren përmes një konsultimi të shkruar pra në bazë të konsensusit të shprehur me shkrim.

Kjo procedure nuk është subjekt i ndonjë formaliteti të vecantë, me kusht që cdo ortak të ketë të drejtën të marrë pjesë në vendim pasi ka marrë një njoftim paraprak dhe nga dokumentat e



nënhkruara të rezultojë qartësisht cështja objekt vendimi dhe aprovimi i saj. Vendimi merret përmes aprovimit me shkrim të një dokumenti të vetëm, pra të më shumë dokumentave që përbajnë të njëjtën tekst të vendimit, nga ana e shumë ortakëve të cilët përfaqësojnë shumicën e sipër cituar.

Procedura duhet të përmbyllt brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e fillimit të tij ose në një afat ndyshe të cituar në tekstin e vendimit.

Vendimi merret me aprovimin e shumë ortakëve që përfaqësojnë 51% (pesëdhjetë e një përqind) të pjesmarrjeve në shoqëri.

Vendimet marrin datën e deklaratës së fundit të ardhur në afatin e parazgjedhur.

Vendimet e marra duhet të regjistrohen pa hezitim në librin e vendimeve të ortakëve.

ADMINISTRIMI – PËRFAQËSIA – NËNSHKRIMI I SHOQËRISË

Neni 16 – Shoqëria mund të administrohet, në mënyrë alternative, me vendim të ortakëve në momentin e emërimit nga një Administrator i Vetëm ose nga më shumë administratorë, nga një minimum prej dy në një maksimum prej shtatë. Kur administrimi i është besuar të paktën tre personave, këta përbëjnë Këshillin e administrimit; administrimi i shoqërisë mund t'i besohet edhe dy apo më shumë administratorëve veçmas por edhe bashkarisht, përvèc rastit kur me ligj i rezervohet kompetencës këshilllore kolegjiale.

Administratorët mund të mos janë ortakë dhe mbeten në detyrë deri në revokimin ose dorëheqjen ose për periudhën e përcaktuar nga ortakët në momentin e emërimit dhe janë të rizgjedhshëm.

Neni 17 – Në rast se ortakët nuk e kanë zgjedhur më parë në momentin e mërimit, këshilli i administrimit emëron një president nga antarët e tij. Thirrja kryhet përmes një njoftimi të dërguar të gjithë administratorëve me cdo mjet të pështatshëm që garanton provën e marrjes, të paktën tre ditë para mbledhjes dhe në rast urgjencë të paktën një ditë përpara. Tek njoftimi caktohen data, vendi dhe ora e mbledhjes si edhe rendi i ditës.

Neni 18 – Këshilli mblidhet pranë selisë së shoqërisë ose edhe gjetkë, vecse në Itali, ose në territorin e një Shteti tjeter antar i Bashkimit Evropian.

Mbledhjet e këshillit dhe vendimet e tij janë të vlefshme edhe pa një thirrje formale, kur marrin pjesë të gjithë këshilltarët në detyrë dhe organi i kontrolit nëse është i emëruar.

Në lidhje me vleshmërinë e vendimeve të këshillit të administrimit kërkohet prania reale e shumicës së antarëve të tij në detyrë; gjithsesi vendimet merren me shumicë absolute të votave të antarëve në detyrë.

Vendimet e Këshillit të administrimit mund të merren edhe përmes një joftimi të shkruar, pra me konsensusin e shprehur me shkrim, përvèc rasteve të parashikuara nga ligji e në rast kur kërkohet nga të paktën dy administratorë.

Kjo procedurë nuk parashikon formalitetë të vecanta, me kusht që cdo ortaku i garantohet e drejta e pjesëmarrjes në vendim pasi është njoftuar paraprakisht dhe në dokumentat e nëshkruara të rezultojë qartësisht cështja obkjeqt vendimi dhe aprovimi i saj. Vendimi merret përmes aprovimit me shkrim të një dokumenti të vetëm, pra të më shumë dokumentave që përbajnë të njëjtin tekst të vendimit, nga ana e shumë ortakëve të cilët përfaqësojnë shumicën e sipër cituar.

Procedura duhet të përmbyllt brenda 3 (tre) ditëve nga fillimi i tij ose në afatin ndryshe të cituar në tekstin e vendimit.

Vendimet e administratorëve duhet të regjistrohen pa hezitim në librin e vendimeve të administratorëve.

Dokumentacioni përkatës ruhet nga shoqëria.


Neni 19 – Organi administrativ ka të drejtë të plota për menaxhimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë, të cilit i është dhënë në mënyrë ekskluzive përgjegjësia e menaxhimit të sipërmarrjes dhe kryerjen e të gjitha veprime të cilësuara të nevojshme për implementimin e objektit të shoqërisë, përjashtuar ato që me ligj ose me statut i rezervohen vetëm asamblesë së ortakëve. Megjithatë gjatë emërimit mund të të përcaktohen kufizimet e të drejtave të administratorëve: në rastin e emërimit të këshillit të administratorit, ky i fundit mund t'i delegojë pjesërisht ose të gjithë të drejtat e tij një administratori të deleguar dhe/ose një komiteti ekzekutiv të përbërë nga disa prej përbërësve të tij, pra një ose më shumë pjestarëve të tij; edhe veçmas, në këtë rast aplikohen dispozitat që përmban paragrafi tre; pesë dhe gjashtë i nenit 2381 k.c. Nuk mund të delegohen detyrat e përcaktuara në nenin 2475, paragrafi i fundit, i K.C. Mund të emërohen drejtorë, përgjegjës ose përfaqësues për kryerjen e veprimeve të caktuara ose kategori veprimesh; duke u përcaktuar detyrat.

Neni 20 - Përfaqësia dhe firma e shoqërisë i takon administratorit të vetëm ose presidentit të këshillit të administratorit ose; në rast të më shumë administratorëve; atyre bashkarisht ose veçmas; në të njëjtën mënyrë siç u janë caktuar detyrat e administratorit gjatë emërimit, si edhe administratorëve të deleguar në kufinjtë e të drejtave të dhëna.

Neni 21 – Adminsitratorëve u takon rimbursimi i shpenzimeve të kryera për arsyet e detyrës së tyre.

Ortakët gjithashtu mund t'u caktojnë administratorëve një rimbursim vjetor në kuotë fikse, pra një kompensim proporcional me fitimet neto të bilancit, si edhe të përcaktohet një rimbursim pas lënies së detyrës e të merret vendimi për lëvrimin e fondit përkatës së largimit sipas mënyrave të përcaktuara me vendim të ortakëve.

Neni 22 - Ortakët që marrin pjesë në administratorim kanë të drejtë të marrin nga administratorët njoftime mbi zhvillimin e biznesit të shoqërisë dhe të konsultojnë, edhe përmes profesionistash të tyre të besuar, librat e shoqërisë dhe dokumentat në lidhje me administrimin.

ORGANI I KONTROLLIT

Neni 23 – Emërimi i organit të kontrollit kryhet në bazë të nenit 2477 të K.C. në rastet e parashikuara në të.

Ortakët mudn të vendosin t'i japid një organi kolegjal funksionet e kontrollit e të rishikimit, ose t'i japid të japid funksione të ndara e të sakta, funksionin e kontrollit ligjor të organit sindikal (unik ose kolegjal) dhe funksionin e rishikimit besuar një rishikuesi të jashtëm.

BILANCI – FITIMET

Neni 24 - Bilanci i shoqërisë mylllet më 31 dhjetor të cdo viti. Në fund të cdo viti Organi administrativ procedon me përpilimin e bilancit sipas ligjit.

Bilanci i aprovuar nga asambleja e ortakëve duhet të depozitohet në regjistrin e sipërmarrjeve sipas afateve ligjore.

Neni 25 – Fitimet neto, pasi është hequr pjesa që i takon rezervës ligjore, do të shpërndahen, përvèc një vendimi ndryshtë të asamblesë, në masën gjithsesi të proporcionuar me pjesëmarrjen që secili zoteron.



SHPËRBËRJE DHE LIKUDIMI

Neni 26 - Me arritjen në cdo kohë e arsyë të shpërbërjës së shoqërisë, asambleja e ortakëve do të përcaktojë mënyrat e likujdimit, dukë emëruar një ose më shumë përgjegjës likujdimi, me funksionet dhe të drejtat e parashikuara nga ligji.

KLAUZOLË PËR MARRËVESHJE

Neni 27 – Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe ndonjë ortak, pra midis vetë ortakëve, administratorëve dhe shoqërisë, si edhe midis shoqërisë dhe trashëgimtarëve të një ortaku që ka ndërruar jetë ose midis këtyre të fundit dhe ortakëve të tjera, dhe që kanë për objekt të drejta të disponueshme në lidhje me kontratën e shoqërisë, do të dërgohen për gjykimin e një arbitri i emëruar nga Presidenti i Gjykatës të vendit në të cilën e ka selinë shoqëria, me kërkësë të palës më të zellshme. Arbitri do të vendlodhi në mënyrë informale, me barazi dhe do të vendlodhi edhe në lidhje me ndarjen e shpenzimeve.

TITUJ DEBIE – DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 28 – Shoqëria mund lëshojë tituj debie në kuadër të sa është parashikuar dhe parashkruar nga neni 2483 i Kodit Civil. Kompetenca përkatëse është funksion i Organit Administrativ.

Neni 29 – Per cdo gje që nuk është parashikuar shprehimisht në statutin në fjalë, i referehoet normave ligjore në fuqi.

Firmosur nga: Giovanni Vito Nitti Putignano, Alessio Gatti, Noter Ernesto Fornaro (me vulë)

Vulë me bojë katrore

Unë i nënshkruari dr. Ernesto Fornaro,
Noter ne Bari i regjistruar në Dhomën
E Tregtisë të Qarkut të Barit që kjo
Kopje e fotokopjuar është në përputhje
Me originalin dhe e lëshoj në nr. 12
Faqesh per përdorim kompetent.
Bari më 6 Shtator 2019
(firma, vula)

APOSTILLE

(Convention de la Haye du 5 octobre 1961)

1. Shteti ITALI
Ky akt zyrtar
 2. Eshte firmosur nga Ernesto Fornaro
 3. Me detyre: noter
 4. Eshte pajisur me vule dhe pulle te: Ernesto
Fornaro i Enzo-s noter ne Barit
- VĒRTETUAR**
5. Ne Bari 6. më 9 SHTATOR 2019
 7. nga Prokuroria e republikes
 8. me numer 1145
 9. Vula, pulla 10. Firma

PROKUROR I REPUBLIKES

(Alessio Cocciali)

(firma, vula)

Përktheu: **Sonila PIRI**
PËRKTHYESE ZYRTARE

SONILA PIRI
TRADUTTORE GIURATO
PERK-NYESE ZYRTARE

Sonile Piri SD

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBETARE E NOTERISE
DEGA VENDORE TIRANE
NOTERE MARSELA BINJAKU
NR. 2194 REP.



VËRTETIM

Vërtetohet firma e përkthyese Sonila Piri përkthyese e gjuhës italiane në listën e Ministrisë së Drejtësisë, banuese në Tiranë, me Karte Identiteti nr. 031163774, e cila më deklaroi se ka përkthyer dokumentin e mësipërm në përputhje me originalin nga gjuha italiane në gjuhen shqipe dhe firmosi rregullisht përpara meje.

Tiranë, më 9.10. 2019

NOTERE

MARSELA BINJAKU

